

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 31203/26

Nr. i fq. / Br. st. - 3 -

Data: / Datum: 16. 07. 2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me grupe të ndryshme të grave

Korrik, 2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për përgatitjen e Buxhetit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2027, i mbajtur me grupe të ndryshme të grave.

Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës

Ora: 14:00

Data: 13.07.2026

Të pranishëm nga Komuna ishin Melihate Basholli Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës, Isuf Jashari, Drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, Hyrie Uka Hoxha, Drejtoreshë e Administratës, si dhe anëtarët e Kuvendit, Fatmire Cecelia dhe Fakete Dushi.

Melihate Basholli Latifi, kryesuese, hapi takimin dhe tha se në këtë takim do të mblidhen kërkesat e grave pjesëmarrëse për përfshirje në buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2027.

Isuf Jashari, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, paraqiti para grave pjesëmarrëse në takim buxhetin e Komunës së Vushtrisë për vitin 2027 dhe projektet e parapara.

Grave të pranishme në këtë dëgjim ju është shpërndarë material informues për buxhetin e vitit 2027.

Më pas, fjalën e morën gratë pjesëmarrëse, të cilat paraqitën kërkesat e tyre.

Vildane Mulaku, kryetare e shoqatës “Martirët e Lirisë”, e cila tha se është viti i dytë që shoqatat nuk kanë marrë subvencione. E falënderoj kryetarin e Komunës së Vushtrisë, i cili i ka realizuar disa kërkesa për shënimin e datave të cilat i bëjmë në kuadër të shoqatës tonë.

I kam edhe dy kërkesa, e para është rregullimi i varrezave të 2 dhe 22 majit, të jenë unike të gjitha varret. Mua si kryetare e shoqatës po më bie të vizitoj vende të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës dhe po e ndiej veten keq kur shoh se varrezat në Studime nuk janë unike. Martirët janë vrarë në të njëjtën ditë dhe unë dhe familjarët kërkojmë që edhe varrezat të jenë të njëjta.

Kërkesa e dytë është për një buxhet më të madh për shoqatën tonë, pasi tashmë fëmijët na janë rritur dhe kemi nevojë të shoqërohemi me gra së paku një herë në javë, për trajnim psikosocial.

Fikrije Ferizi, kryetare e shoqatës “ATO”, kërkoi të bëhet ndriçimi i rrugës “Haxhi Zeka” në qytet, të ketë transport në zonat e thella rurale siç është fshati Zhilivodë, trajtimi i qenve endacak.

Nerxhivane Krasniqi, drejtoreshë e shoqatës “GIGVA”, e cila tha se ky grup ka 35 anëtare, të cilat janë gra nga viset rurale dhe kërkoi që të ndahet një fond i veçantë për shoqatat që veprojnë në viset rurale për gratë ndërmarrëse.

Remzije Zekolli, udhëheqëse e Zyrës për Barazi Gjinore, e cila i njoftoi të pranishmet rreth hapjes së aplikimit për financimin e grave ndërmarrëse nga viset rurale nga Integra, ku vlera e projektit është 3000 euro.

Florentina Osmani, banore e fshatit Dolak, kërkoi asfaltimin e rrugës “Katër Martirët” në këtë fshat, e cila dërgon tek ferma e familjes Osmani.

Hata Shyti, banore e fshatit Oshlan, kërkoi asfaltimin e rrugëve “Musfat Shyti” dhe “Vesel Shyti” në këtë fshat.

Procesmbajtëse:

Remzije Zekolli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri



LISTA E PJESËMARRËSVE

Dëgjim buxhetor me grupe të ndryshme të grave për draft-buxhetin e Komunës së
Vushtrrisë për vitin 2027

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 13.07.2026

Ora: 14:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Fikrije Ferizi	Flem	Vushtri
2	FATMIRE SARACI	Fatmir	GZAUOTIN
3	Teuta Salihu Vllani	Teuta	VUSHTRRI
4	Albane Abazi	Alban	Vushtrri
5	Agnesa Asllani	Agnesa	Vushtrri
6	Valmira Klinaku	Vlmir	Vushtrri
7	FLORIANA TEKA ZAHITI	Fleka	VUSHTRRI
8	MERGIME BERISHA RASHICA	Mergime	Vushtrri
9	Alleina Rama	Alleina	
10	Taibe Hajdini	Hajdini	Vushtrri
11	Blerima Gubetimi	Blerim	VUSHTRRI
12	Fikrete Sadiku	Fikre	Vushtrri
13	Lirije Kuci Krasniqi	Kuci	Vushtrri
14	FLORIANA LECRU SARICU	Flash	Vushtri
15	ELVIRA RAMA	Elvira	Vushtrri



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



LISTA E PJESËMARRËSVE

Dëgjim buxhetor me grupe të ndryshme të grave për draft-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027

Vendi: Kuvendi i Komunës

Datë: 13.07.2026

Ora: 14:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
16	Besarta Shala Haradinaj	Besarta Shala	St. Epërm
17	DONIKA SƏIMI	Duusheli	VUSHTRRI
18	BASTRIE	B.M.	F. Kosovë
19	AZEMINE RASHICA	A. Rashica	VUSHTRRI
20	Fatmirë Aliu	Begaj	Begaj
21	Lemçe Idriz	Idriz	Vushtrri
22	Vildane Melbani	Melbani	Vushtrri
23	Ajshë Zekaj	Zekaj	Vushtrri
24	Mynete Shala	Melbani	Vushtrri
25	Mynete Bajrami	Melbani	Vushtrri
26	Arjeta Kadriu	Kadriu	Vushtrri
27	Florentina Osmani	Osmani	Dolak
28	Hotë Shyti	H. shyti	oshlah
29	Nexhivane Krasni	Umanj	Zhilivodë
30	Ponjetë Latifi	Bull	Pestovë